



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2472/ 17 prot.

Datë 19/11/2024

V E N D I M
Nr. 1633/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19/11/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1541/2024, datë 31.10.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK me NIPT K87921701H dhe L03425410B, me adresë: Rruga “Hasan Riza Pasha”, Shkodër.

Subjekte të Interesuara:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK me NIPT L46827004L dhe J61902509S me adresë: Rruga “Daut Boriçi”, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Adresa: Rruga “Sami Frashëri” Nr.33, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 31.11.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1541/2024, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK në lidhje me skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK nga procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK si dhe të korrigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 6747/3 prot., datë 12.11.2024, protokolluar me tonën nr. 2472/14 prot., datë 15.11.2024, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1541/2024, datë 31.10.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 6747/3 prot., datë 12.11.2024, protokolluar me tonën nr. 2472/14 prot., datë 15.11.2024, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1541/2024, datë 31.10.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1551/2024 datë 31.10.2024, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar statusin bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1541/2024, datë 31.10.2024 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike*”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “*Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)*”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

